



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 3517 prot.

Datë 30.09.2021

SH P A L L J E

Në Bashkinë Gramsh

Midis Bashkisë Gramsh, si palë enfiteozëdhënëse dhe subjektit "KS & KLESI", si palë enfiteozëmarrëse është lidhur kontratë enfiteoze me nr. 347 rep., 158 kol., më dt. 05.03.2015 për pasurinë me nr. 10/311 e regjistruar në Vol. 21 faqe 95 me sipërfaqe totale 4087 m², nga kjo truall funksional 3270 m², si dhe sipërfaqe ndërtimi 817 m², Bashkia Gramsh.

Me vendimin nr. 128 dt.28.08.2021 të Kryetarit të Bashkisë është zgjidhur kjo kontratë për shkak të mosrespektimit të kushteve të kontratës (nuk është kryer asnjë pagesë enfiteoze nga momenti i lidhjes së kontratës) dhe planit të biznesit (lidhur me numërin e punonjësve të punësuar, ku nuk është respektuar palni i biznesit).

Me dt. 25.08.2021 u dërgua vendimi në objektin ku subjekti "KS & KLESI" ushtron aktivitetin, në Bashkinë Gramsh, për të cilin është lidhur edhe kontrata e enfiteozës, por në datë 27.08.2021 me nr. Prot 3180/2 me lajmërim-marrje informohemi se subjekti është larguar. Në datë 30.08.2021 vendimi është dërguar në zyrën qendrore ku subjekti "KS & KLESI" ushtron aktivitetin, por në datë 20.09.2021 me nr. Prot 3180/4 me lajmërim-marrje informohemi se subjekti është i panjohur.

Në bazë të kodit të procedurës Administrative neni 162, pika 1 dhe 2 shpallim vendimin nr. 128 dt. 23.08.2021 në hollin para bashkisë dhe në faqjen Zyrtare të Bashkisë, për 10 ditë.

Bashkëlidhur kësaj shkrese edhe vendimin nr. 128 dt. 23.08.2021.

Kjo shpallje hartohet në tre kopje .

Ju faleminderit për bashkëpunimin .

K R Y E T A R I

Klodian TAÇE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI

Nr. 3180 prot.

Gramsh, më 23.08.2021

V E N D I M

Nr. 128 datë 23/08 /2021

“PER

**ZGJIDHJEN E KONTRATËS SË ENFITEOZËS NR. 347 REP, 158 KOL, DATË
05.03.2015”**

Referuar Kontratës së Enfiteozës Nr.347 rep 158 kol , date 05.03.2015 të lidhur midis palëve, enfiteozëdhënësi: bashkia Gramsh dhe enfiteozëmarrësi: subjekti “KS & KLESI” Shpk, për dhënien me qira te objektit “ish-Uzina e Pilave” godinë 1 katëshe, lloji i pasurisë “truall”, me sipërfaqe totale 4087 m², nga kjo truall funksional 3270 m², si dhe sip. ndërtimi 817 m², me nr. Pasurie 10/311 e regjistruar në Vol. 21 faqe 95, objekt ne pronësi të bashkise Gramsh, adresa e pasurisë Gramsh, Lagja “Sporti”, rezulton e papaguar qiraja mujore për periudhën nga momenti i lidhjes së kontrates së enfiteozës deri në ditën e sotme. Në këto kushte, bazuar në njoftimet e njëpasnjëshme për zgjidhjen e kontratës, nenit 6 dhe 7 të kontratës së sipërcituar, nenit 698, 700, 791 pika 2 te Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, VKM-së nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrit të Zhvillimit të Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrje nr. 6756 date 03.09.2015 “Për zbatimin e VKM-së nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shtetërore”, si dhe Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, pika 2;

V E N D O S A

1. Të zgjidh në mënyrë të njëanshme për shkelje të kushteve të kontrates, kontratën e Enfiteozës Nr.347 rep. 158 kol, datë 05.03.2015, të lidhur midis palëve, enfiteozëdhënësi: bashkia Gramsh dhe enfiteozëmarrësi: subjekti “KS & KLESI” Shpk për arsyet si më poshtë:
 - Nuk ka kryer asnjë pagesë enfiteoze që nga momenti i lidhjes së kontratës;
 - Nuk ka respektuar parashikimin e pikës 5.4 të kontratës së enfiteozës për të kryer 27 100 698 lekë investime në objektin e marrë me qira;
 - Nuk ka zbatuar kushtet e kontrates lidhur me numrin e punëtorëve të shprehur në planbiznesin e tij në konkurim dhe të pasqyruar në kontratë;
 - Pas njoftimeve te njëpasnjëshme për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale nuk ka patur asnjë reagim nga enfiteozëmarrësi;
2. Te njoftohet administratori i subjektit qiramarres per lirimin e objektit “ish-Uzina e Pilave” brenda 15 ditëve nga marrja njoftim për zgjidhjen e kontratës.

3. Te lirohet vullnetarisht objekti nga qiramarrësi në të kundërt do të merren masa për lirim me force.
4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Njësia e Monitorimit e ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr. 12, date 10.02.2015.

K vendim hyn në fuqi menjëhere!

KRYETARI
Klodian TACE

